



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 60

Datë: 03. 11. 2017, ora: 12:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Stevan Veselinoviq, Ercan Spat, Bajram Ljatifi dhe Ergit Qeli

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP; Përkthyes: Vera Dula

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.59/ 2017;*

2. Certifikimi i Rezultateve për Kryetar të komunave për zgjedhjet e 22 tetorit 2017;

3. Raport i Këshillave të KQZ-së ;

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit dhe përmbajtjes së Fletëvotimit për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të komunave 2017;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i sasisë së Fletëvotimeve për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave 2017;*

4. Të ndryshme

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Valdete Daka: Përshendetje të gjithëve. Mirë se keni ardhur në mbledhjen numër 60-të të KQZ-së! A ka dikush vërejtje në rendin e ditës? Nëse jo, kush është për këtë rend dite? Faleminderit.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës

Valdete Daka: Pika e pare, është procesverbali i mbledhjes së kaluar. A ka dikush vërejtje në këtë procesverbal...? Nëse jo, atëhere kush është për miratimin e procesverbalit?

Anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së nr.59/ 2017

2. Certifikimi i Rezultateve për Kryetar Komune për zgjedhjet e 22 tetorit 2017

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën e dytë, me certifikimin e rezultateve për kryetar komune për zgjedhjet e 22 tetorit. A doni t`i certifikojmë një nga një komunat, apo...? Unë po i lexoj me rashë se cilat komuna do të certifikohen. A certifikohet rezultati për kryetar të komunës së Deçanit, Gjakovës dhe Dreanasit...? Jo, meqenëse ka ankesë...Gjilani, Dragashi, Istogu jo, Kaçaniku po, Klina, Fushë Kosova, Kamenica jo, Mitrovica e Jugut po, Leposavici, Lipjani, Novoberda, Obiliqi jo, Rahoveci po, Peja po, Podujeva po, Prishtina po, Prizreni, Skenderaj po, Shtimja po, Shterpeca po, Suhareka po, Ferizaj po, Vitia po, Vushtrria po, Zubin Potok po, Zveçani po, Malisheva po, Juniku jo, Mamusha po, Hani i Elezit po, Graçanica po, Ranillugu po, Parteshi jo, Klllokoti jo, Mitrovica e Veriut po...Certifikohet edhe Klllokoti...Ato që nuk certifikohen, janë: Kamenica, Parteshi, Istogu, Obiliqi, Drenasi dhe Junikut. Ndërkaq, në të gjitha komunat tjera certifikohen rezultatet. Meqenëse, për këto 6 komuna ka ankesa në PZAP dhe deri më tani nuk ka përgjigje në këto ankesa, KQZ ka vendosur që për shkak se afati është shumë i shkurtër, meqenëse kemi komuna të cilat do të shkojnë në balotazh, pra janë 16 komuna të cilat do të shkojnë në balotazh, plus këto 3 komunat në të cilat ankesa, ka vendosur që të bëjë certifikimin e 32 komunave. Pra, për 6 komuna për të cilat ka ankesa pranë PZAP-së, do t`i presim rezultatet e këtyre ankesave dhe, pastaj do të veprojnë.

Ne, duhet ta bëjmë certifikimin sepse, rezikohet procesi i shtypjes së fletëvotimeve për Raundin e Dytë për komunat të cilat do të shkojnë në balotazh dhe procedurat e tjera dhe afatet ligjore të cilat, vetëm kanë filluar të rrjedhin. Atëhere, kush është që të certifikohen rezultatet përfundimtare për këto 32 komuna, përveç këtyre 6 komunave të cilat unë i lexova më lartë?

Anëtarët e KQZ-së me vota unanime miratuan certifikimin e rezultateve për Kryetar Komune në 32 komuna

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1.Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit dhe përmbajtjes së Fletëvotimit për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të komunave 2017;

Valdete Daka: Këshilli për operacione zgjedhore. Udhëro Eshref...!?

Eshref Vishi: Faleminderit kryetare. Të nderuar kolegë: Këshilli për Operacione Zgjedhore, në takimin e mbajtur sot, shqyrtoi pikën “Miratimi, dizajnimi dhe përmbajtjes së fletëvotimit për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetarë Komune 2017”, dhe i rekomandon KQZ-së miratimin e kësaj pike. Format i fletëvotimit, është standard nga zgjedhjet e mëhershme për balotazh, i cili është i formatit A5, me dimension 148 x 210, ku përfshihen të gjitha karakteristikat dhe përmbajtja e fletëvotimit. Ky raund, zhvillohet në 19 komuna të Republikës së Kosovës, e ku në 3 komuna që i përmendët më herët, Istogu, Kamenica dhe Obiliq nuk përfshihen në shqyrtimin dhe miratimin e kësaj mbledhje për arsye se janë në procedurë të anikimit sipas ligjit.

Teksti i fletëvotimeve, tha z. Vishi, i përmbush standardet ligjore dhe karakteristikat e fletëvotimit për Kryetarë Komune, e ku përfshihen llogoja e KQZ-së, emrat e subjekteve politike, përkatësisht të kandidatëve siç janë paraqitur për certifikim, së bashku me numrat rendor të caktuar me short dhe llogoja e subjektit politik, duke përfshirë edhe ngjyrën e fletëvotimit dhe gjuhët zyrtare...

Valdete Daka: E pata një vëretje të vogël që na mundemi t’i certifikojmë, dhe mund ta aprovojmë dizajnin, dhe formatin për të gjitha, ndërkaq, përmbatjen vetëm për 16 komuna të cilat i kemi certifikuar, d.m.th., dizajni dhe formati i fletëvotimit për Raudin e Dytë aprovet për të gjitha komunat, ndërkaq, përmbatja varet nga komuna e Istogut, pra përjashtohet kjo komunë, si dhe Kamenica dhe Obiliq...Gjithashtut, kisha dashtë me shtuar se, të gjitha këto së bashku me numrin rendorë të caktuar në short, a mbeten kështu...? Nëse po, kush është pra që të aprovet “Dizajni dhe formati” për 19 komuna dhe, “Dizajni dhe përmbatja” për 16 komuna që u certifikuan...?

Adnan Rrustemi: Për mos pas nevojë edhe një herë me vendos për tri komunat e tjera në kuptimin e një kandidati, ne e miratojmë sot dizajnin, formatin edhe kuptimin e elementeve të përgjithshëm për të gjitha komunat...Nuk është e thanë me e precizuar numrin, kemi kohë dhe nevojë edhe për një vendim tjetër për me marrë me certifikuar...

Valdete Daka: Pajtohem plotësisht, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e KOZ-it për certifikimin e këtyre rezultateve

2.Shqyrtimi dhe miratimi i sasisë së Fletëvotimeve për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave 2017

Eshreh Vishi: Pika tjetër e rendit të ditës është sasia e fletvotimeve për Raundin e Dytë për zgjedhjet për Kryetar Komune. Llogaritja e sasisë është bërë sikurse në zgjedhjet e kaluara ku numri i fletëvotimeve do të jetë më pak se numri i votuesve, se në përqindje i bie 4.77% numri i votuesve që do të votojnë për raundin e dytë është 1 milion e 353 mijë e 613, ndersa do të shtypen 1 milion 218 mijë e 950 fletëvotime, ose 64.663 % e fletë votime më pak se numri i votuse për komunat që shkojnë në balotazh. Në këtë rast, duhet ta kemi parasysh votimin jashtë Kosovës, përkatësisht periudhën e votimit sa i përketë kësaj peridhe të raundit të dytë të zgjedhjeve që fillon nesër, më 4 nëntor, dhe përfundon me 17 nëntor. Lidhur me këtë miratim të fletvotimeve për 16 komuna, kërkohet pajtimi i KQZ-së që, procesi i votimit jashtë Kosovës të fillojë nesër...

Valdete Daka: Faleminderit, kush është për këtë rekomandim...?

Anëtarët e KQZ-së miratuan edhe këtë rekomandim të Këshillit për Operacione Zgjedhore

Adnan Rrustemi: Vetëm diçka: në tabelën e fletvotimeve kisha kërkuar nga Sekretariati që me ua përcjellë edhe KKZ-ve, mos me pasë asnjë keqëkuptim në ditën e zgjedhjeve nëse do të mungojë diçka, pse ka ma pas ma pak fletëvotime se sa votues. Të njëjtën tabelë lidhur me atë se sa e ka numrin e votuesve secili vendvotim, dhe sa është numri i rumbullaksimeve në atë vendvotim...

Valdete Daka: Sa fletëvotime i ka Gjakova, Gjilani, Dragashi, ta ketë secila KKZ...

Binak Vishaj: Ekipet mobile...Mos të ndodh që fletëvotimet të jenë mbi fletëvotime të rregullta, të përsëritet raundi i parë, të merren nga rezervat që mos ta kemi një situatë si në raundin e parë... Edhe pse është e kuptueshme për neve, kjo të dihet për opinion...Ka pasur pak dilema, tash mos të ndodh e njëjta gjë sepse, jemi në kohë me evituar si problem...

Adnan Rrustemi: Ne, edhe si institucio, nuk e di sa e ka problemin përveç asaj që e tha edhe Binaku..Idea është edhe aspekti procedural i zarfave që, mos me u trajtuar me vota me kusht që, mos me ndodhë nëse konsiderohet me ndryshuar tash, të paktën mos të bëjmë veprime sa për sy e faqe që krijojnë dilemma, ose votojnë në menyrë të rregullt edhe procesohen, ose nuk realizohet fare...

Enis Halimi: Ne, i kemi marrë masat për çështjet që janë ngritur në të kaluarën menjëherë pas procesit zgjedhor, qoftë për fletëvotimet nga rezervat, pra është bërë një ngatërrim teknik në kuptim të përzirjes së fletëvotimeve... Po ashtu, edhe te votuesit nëpër institucione ne do të marrim masa që të validohet secila vote, dhe e cila është e vlefshme por, edhe të procesohet ashtu sikur e do rendi...

Adnan Rrustemi: Në këtë aspekt, për me u siguruar që vlerësohet dhe merret çdo vote në konsideratë... Ju, duhet me krijuar lista të votuesve të veçanta të atyre që janë në institucione. Mbase, edhe në nivel të Sekretariatit që u dërgohen komisioneve komunale në fjalë, emrat dhe mbiemrat, dhe numrat personal..., pse jo, edhe duke i gjeneruar prej listës aktuale të votuesve, prej regjistrimit civil...! Dhe, të njëjtat të vulosen në listën përfundimtare

të votuesve...Ata, votojnë në mënyrë të rregullt në instucine, jo me kusht, dhe kështu teknikisht, s'i sugjerim sepse, kam frikë se KKZ-të nuk mundën me i realizuar...

Enis Halimi: Jo vetëm në nivel të KKZ-ve, por edhe nga shërbimi përkatës, pra shërbimi votues...

Valdete Daka: Nëse nuk kemi diçka tjetër...? Faleminderit...

Për KOZ

Valdete Daka, kryetare

=====